




AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK	Nr. Prot. 03-02/4821/16
Dep. 02	Dire. 20-12-2016



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.12.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-3373/16, për z. Qazim Krasniqi – Zyrtar Kryesor Financiar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-3373/16, për z. Qazim Krasniqi – Zyrtar Kryesor Financiar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Krasniqi, është hetuar për konflikt interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat N.SH. “Home Clean”.

Ai fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, z. Krasniqi është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Krasniqi, është bindur për kufizimin e funksionit menaxherial në biznesin privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për t'i bërë ndryshimet e nevojshme.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë me të cilën vërtetohet se ai ka emëruar një “person të besueshëm”, në funksionin e personit të autorizuar, ashtu siç parashihet me Ligjin PKI. Me këtë ai ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtori Agjencisë kundër Korrupsionit

Shqip. Haxholli

